



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY


Dep. 03-02/DPK  
 Nr. Prot. 01-576/16  
 Br. Prot. Prot No  
 Nr. i faq. 02  
 Data 11.02.2016  
 Broj stranica  
 Nr. pages  
 PRISHTINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

<b>DATE/A:</b>	11.02.2016
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK-03-02/3026/15
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Florim Isufi, Anëtar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari z. Isufi,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 pika 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, në rastin e ushtrimit të funksionit Prodekan Çështje Financiare në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe njëkohësisht Anëtar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

## O P I N I O N

Ushtrimi i funksionit Prodekan për Çështje Financiare në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe njëkohësisht Anëtar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore nuk paraqet konflikt interesit. Zyrtari i lartë z. Isufi mund të ushtroj funksionet nën kufizimin e përcaktuar të nenin 15 (paragrafi 3) të Ligjit Nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit.

## A R S Y E T I M

Agjencia kundër Korrupsionit është institucion i pavarur të cilit me Ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bën edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Nr.04/L-051, ka parapa kufizime, dhe ndalesa për zyrtarët e lartë, në situatë kur mund të ketë ose mund të shfaqet konflikti i interesit.

Po ashtu në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Nr.04/L-051, në nenin 4 të këtij Ligji, janë të përcaktuar kategoria e zyrtarëve të lartë publik. Zyrtari i lartë z. Isufi hynë në mesin e kategorisë së zyrtarit të lartë dhe i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të këtij Ligji.

Lidhur me pyetjen tuaj për situatë të konfliktit të interesit në rast të ushtrimit të funksioneve të lartëcekura ju njoftojmë se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Nr. 04/L-051, këtë situatë e ka rregulluar me nenin 15 (paragrafi 3) në të cilin shprehimisht thuhet :

Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organeve drejtuese dhe mbikëqyrës i personave juridik jo fitimprurës dhe personave juridik tjerë të cilat kryejnë pune nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, por nuk ka të drejtë të pranimit të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme, përveç nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera.

Prandaj, zyrtari i lartë z. Isufi, krahas ushtrimit të funksionit Prodekan për Çështje Financiare në FSHMN, mund të ushtroj edhe funksionin Anëtar i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me kufizimin e përcaktuar në nenin e lartëcekur.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik gjithnjë duhet të parasysh deklarin rast për rast të interesave private lidhur me vendimarrjen e tij neni 13 ( paragrafi (1,2,3) të Ligjit Nr.04/L-051.

Me respekt!